1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të

ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 tëLPP dhe nenin 75 tëVKM 285/2021, të ndryshuar.

- 3.Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
- 4.Nëse, AutoritetiKontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për tënjëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

EKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca2: Formulari i Ofertës Ekonomikenë rastine procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca8: Formularii Kriteria të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]**në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁵Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur nëvlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa vlerëdo të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

MM1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia	Sasia
	Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme			
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	96
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	8472
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë	144
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë	264
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë	135
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	2976
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë	324
8	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	1800

9	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	2100
10	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	8900
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë	900
12	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm2, me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm2 fibrile kolageni ose ekuivalent	Copë	10
13	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensionin e nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë	1100
14	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear	9400
15	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë	950
16	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë	3900
17	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë	6800
18	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padepertueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë	4000
19	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë	5
Sisteme dhe doreza				
20	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë	89600
21	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Jostatile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë	89000
22	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me reze Gama ose gaz Etilen <u>sipas normativave EN ose SSH</u> madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale	13300
23	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë	4000
Materiale konsumi per				

	respirim, aspirim, infuzion			
24	Absorbues CO2 per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	Kg	5
25	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë	600
26	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë	2100
27	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë	170
28	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet	90
29	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë	20
30	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë	40
31	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë	36
32	Pleurovac me regullator tub zgjates me varse per krevat	3-chambers, tub zgjatues silikoni 1.8-2m, vellimi mbi 2100-2500ml, pajisur me rregullatore te integruar presioni dhe lageshtie dhe valvol sigurie	Copë	15
33	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë	10
34	Kateter venoz Seldinger 2-rruges	me dy rruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë	5
35	Urinokol pediatrik		Copë	450
36	Kapese kordoni umbilikal		Copë	100
37	Zhgute		Copë	500
38	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë	400
39	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë	120
40	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë	200
41	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë	50
42	Maske Laringeale PVC	Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë	70
43	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë	200
	Materiale konsumi per monitorim diagnostike			
44	Leter printeri ECHO		Copë	320
45	3-kanale		Copë	800
46	Leter printer monitori		Copë	60
47	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë	52
48	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë	20
49	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë	4600
50	Aparat tensioni	Me manometer	Copë	110
51	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë	110
52	Termometer	termometer pacienti	Copë	400
53	Spatula (druri)	Sterile, e pakeluar individualisht	Copë	17000
54	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set	180

55	Gojez spirometrike		Copë	1600
56	Sensor oksimetrine	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë	5

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimete teknike te pergjithshme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Blerje materiale mjekimi te pergjitheshme per nevojat e Drejtorise se Sherbimit Spitalor Pogradec”(MM1)_

Nr.	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia	Sasia per 12 muaj	Destinacioni	Periudha e dorezimit
	Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme					
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	Copë	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	8472	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë	144	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë	264	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë	135	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	2976	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK

7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë	324	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
8	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	1800	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
9	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	2100	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
10	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	8900	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20 , 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë	900	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
12	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm2, me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm2 fibrile kolagjeni ose ekuivalent	Copë	10	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
13	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensionimi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde të qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë	1100	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
14	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear	9400	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
15	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë	950	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
16	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofili, pakete 100g	Copë	3900	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK

17	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë	6800	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
18	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padeptueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë	4000	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
19	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë	5	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
	Sisteme dhe doreza					
20	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë	89600	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
21	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë	89000	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
22	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN ose SSH madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale	13300	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
23	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë	4000	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
	Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion					DSSH Pogradec
24	Absorbues CO2 per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	Kg	5	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK

25	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë	600	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
26	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë	2100	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
27	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë	170	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
28	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar për medikamente	komplet	90	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
29	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë	20	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
30	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima në neseore të detektueshme nga rrezet X	Copë	40	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
31	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë	36	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
32	Pleurovac me regullator tub zgjatues me varse për krevat	3-chambers, tub zgjatues silikoni 1.8-2m, vëllimi mbi 2100-2500ml, pajisur me rregullatore të integruar presioni dhe lageshtie dhe valvol sigurie	Copë	15	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
33	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë	10	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
34	Kateter venoz Seldinger 2-rugesh	me dy rrugë, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë	5	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të AK
35	Urinokol pediatrik		Copë	450	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave të

						AK
36	Kapese kordoni umbilikal		Copë	100	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
37	Zhgute		Copë	500	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
38	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë	400	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
39	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë	120	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
40	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë	200	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
41	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë	50	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
42	Maske Laringeale PVC	Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë	70	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
43	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë	200	DSSH Pogradec	Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
	Materiale konsumi per monitorim diagnostike					Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
44	Leter printeri ECHO		Copë	320		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
45	3-kanale		Copë	800		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK

46	Leter printer monitori		Copë	60		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
47	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë	52		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
48	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë	20		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
49	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë	4600		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
50	Aparat tensioni	Me manometer	Copë	110		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
51	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë	110		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
52	Termometer	termometer pacienti	Copë	400		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
53	Spatula (druri)	Sterile, e paketuar individualisht	Copë	17000		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
54	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set	180		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
55	Gojez spirometrike		Copë	1600		Brenda afatit të MK sipas nevojave te AK
56	Sensor oksimetrine	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë	5		Brenda afatit të MK sipas nevojave te

						AK
--	--	--	--	--	--	----

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023,2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të perlllogaritur.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e

përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektroin publik, autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimit të cilësisë" /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, **ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.** Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë."

Çertifikata kërket të jetë origjinale ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-ve

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.3 Ofertuesi duhet të jete i certifikuar me ISO 9001:2015 për Import,eksport ,tregetim të materialeve mjekesore ose ekuivalente të vlefshme, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit. Çertifikata kërket të jetë origjinale ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme

Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. Çertifikata kërkohet të jetë origjinale ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i permbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-ve

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:*

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë vendin e prodhimit të mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 3 "Lista e cmimeve të artikujve të DST")

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese/ MAH /ose nga Distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë, ku në çdo rast të provohet/ dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregetojë artikujt objekt prokurimi. Autorizimi kërkohet të jetë origjinal i perkthyer në gjuhën shqipe, ose kopje e perkthyer dhe të noterizuar, i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregëtim të pajisjeve mjeksore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas ligjit 89/2014 datë 17.07.2014 "Për pajisjet mjeksore"

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të shihen me numër rendor sipas numrit rendor të artikullit në ***Shtojcën 3, Lista e cmimeve të artikujve***. Në katalog artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST.

(pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike**, për artikujt objekt prokurimi sipas numrit rendor në Shtojcën 3 "Lista e cmimeve të artikujve" në formë tabele, ku të pasyrohet: Emertimi i artikullit, Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit /

produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet,

Numri i faqes ku ndodhet: Autorizimi i prodhuesit, certifikata ISO, CE ose FDA, te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara per secilin artikull te ofertuar.

2.3.10 Operatori ekonomik te paraqes nje vetedeklarim ne rast se shpallet i sukseshem ***“Të gjitha pajisjet mjekësore, që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ne perputhje me nenin 13, te Ligjit 89/2014, i ndryshuar.***

Shënim për operatorët ekonomik:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

• CERTIFIKATAT E CILËSISË

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

